



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

# Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë  
Kundër Korrupsionit  
Shtator-Tetor 2011



British Embassy  
Pristina

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Britanike në Kosovë. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e Ambasadës.

### Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Hyrje	4
Qeveria e Kosovës	5
Kuvendi i Kosovës	6
Sistemi Gjyqësor	7
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	7
Policia e Kosovës	8
Doganat e Kosovës	8
Falënderime	9
Rreth Lëvizjes FOL	9

### Lista e Akronimeve/Shkurtesave

**AAK** - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

**AKK** - Agjencia Kundër Korrupsionit

**DHKEK** - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

**DG** - Doganat e Kosovës

**EULEX** - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

**KGJK** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**LDK** - Lidhja Demokratike e Kosovës

**PDK** - Partia Demokratike e Kosovës

**PK** - Policia e Kosovës

**VV** - Lëvizja Vetëvendosje!

### Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Kosovës gjatë dy muajve (shtator-tetor) ka miratuar gjithsej 61 (gjashtëdhjetë e një) vendime, nga të cilat 25 janë në muajin shtator, 36 në tetor. Në muajin shtator nga 25 vendime të marra vetëm 1 është i lidhur me sektorin kundër korrupsion, kurse në muajin tetor Qeveria ka nxjerr dy vendime të fushës kundër korrupsion.

Kuvendi i Kosovës gjatë muajve shtator- tetor 2011 ka mbajtur 3 seanca plenare, nga të cilat njëra është mbajtur gjatë muajit shtator dhe dy tjerat në muajin tetor. Nga këto tri seance plenare për këto dy muaj, vetëm në seancën e muajit shtator është diskutuar për çështjen kundër korrupsion, respektivisht gjatë seancës së muajit shtator ku është zgjedhur drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsion.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Bazuar në statistikën e këtij institucioni për muajin gusht-shtator shohim se në kuadër të kategorisë “shpërdorim i detyrës zyrtare” 14 lëndë janë pranuar në punë, asnjë lëndë në ka qenë në shqyrtim dhe vetëm 9 lëndë janë zgjidhur. Në kuadër të kategorisë “marrje e ryshfetit” kemi 2 lëndë të pranuar në punë dhe vetëm 1 lëndë është zgjidhur në fund të periudhës raportuese. Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi vetëm një lëndë të pranuar në punë dhe 1 lëndë po ashtu të zgjidhur në fund të periudhës raportuese.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se në muajt shtator-tetor janë dërguar gjithsej 44 lëndë në Prokurori: 16 raste në muajin shtator dhe 28 raste të tjera në muajin tetor. Prej hetimeve të Policisë së Kosovës 13 zyrtarë kanë përfunduar të arrestuar: 4 në muajin shtator dhe 9 në muajin tetor. Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përlllogarit të jetë 679,285.00 €: 398,170.00 € në muajin shtator dhe 281,115.00 € në muajin tetor.

Doganat e Kosovës gjatë dy muajve kanë shqiptuar gjithsej 11 masa disiplinore. Në kuadër të tyre 2 kanë qenë në muajin shtator dhe nëntë tjerat në muajin tetor. Në kuadër të këtyre masave disiplinore 9 raste janë vërejtje me shkrim, 1 rast ndalim promovimi dhe një vërejtje gojore.

### Hyrje

Niveli i lartë i korrupsionit<sup>1</sup> dhe shtrirja e gjerë e tij në instancat më të larta dhe më të ulëta qeverisëse përbën rrezikun kryesor për proceset e shtet-ndërtimit<sup>2</sup>, zhvillimin ekonomik<sup>3</sup>, transicionin demokratik<sup>4</sup> dhe qeverisjen cilësore<sup>5</sup>. Ky konstatim pranohet gjerësisht nga segmente të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Të gjithë pajtohen se korrupsioni jo vetëm që është duke i dëmtuar interesat e qytetarëve të Kosovës, por edhe procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.<sup>6</sup> Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar ka alarmuar edhe deputetët e Bundestagu-t gjerman. Disa nga ata kanë pohuar që “paratë e qytetarëve gjermanë po investohen në vila private të politikanëve kosovare”.<sup>7</sup> Në këtë linjë janë edhe raportet e shumta prestigjioze ndërkombëtare. Ato kanë pasqyruar një shkallë të lartë të korrupsionit, krimit të organizuar dhe ekonomisë informale.

---

1 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës sanksionon 13 lloje të veprave korruptive: shpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit, përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrim në detyrë, përdorim i paautorizuar i pasurisë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, ushtrim i ndikimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, zbulim i fshehtësive zyrtare, falsifikim i dokumenteve zyrtare, arkëtim dhe pagesa e paligjshme, lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, përvetësim i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

2 Kjo tezë është rezultat i observimeve empirike, pasi që niveli i lartë i korrupsionit po e dëmton seriozisht legjitimitetin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar të Kosovës

3 Më shumë rreth efekteve negative dhe të dëmshme të Korrupsionit shih <http://www.oecd.org> dhe website-n dhe Raportet e Transparency International: <http://www.transparency.org>

4 James B. JACOBS: Korrupsioni dhe Demokracia, Kappa Phi Journal, Volumi 84, 2004, fq. 21

5 United States Agency for International Development (USAID) - Të luftosh korrupsionin: [http://www.usaid.gov/our\\_work/democracy\\_and\\_governance/technical\\_areas/anti-corruption/](http://www.usaid.gov/our_work/democracy_and_governance/technical_areas/anti-corruption/)

6 Renzo DAVIDDI: Korrupsioni po e dëmton procesin e integritetit të Kosovës në BE, Koha Ditore, 11 qershor, 2010, fq. 6

7 Florian HAHN, Botuar në Koha Ditore: Deputetët gjermanë akuzojnë Qeverinë e Kosovës për krim dhe korrupsion, 11 qershor, 2010, fq. 4

Bazuar në të gjeturat e tyre Kosova renditet krahas shteteve më të korruptuara në botë dhe përkrah shteteve të dështuara. Derisa bartësit institucionalë kanë premtuar se do ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, opozita ka shprehur kritikën, akuzat dhe mosbesimin e saj. Në këtë kontekst, duke parë me shqetësim të madh këtë fenomen endemik, Lëvizja FOL, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Kosovë, është duke e realizuar projektin e saj ‘Monitoruesi i Korrupsionit’. Përmes këtij projekti FOL mëton të nxjerrë në shesh (mos)punën e institucioneve karshi korrupsionit, duke ndikuar që kjo luftë të jetë në krye-agjendën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës”.<sup>8</sup> FOL konsideron se lufta ndaj korrupsionit duhet të kalojë nga sfera e retorikës në atë të veprimeve konkrete, qasjes serioze dhe rezultateve të prekshme. Kjo është rruga e vetme që Kosova ta përmirësojë legjitimitetin e saj të brendshëm dhe ndërkombëtar. Ta etablojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të jetë e krahasueshme me shtetet perëndimore dhe shoqëritë e lira.


---

8 Hasan PRETENI - Edicioni i Lajmeve (19:30), RTK, 6 qershor, 2010

### Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës gjatë dy muajve (shtator-tetor) ka miratuar gjithsej 61 (gjashtëdhjetë e një) vendime, nga të cilat 25 janë në muajin shtator, 36 në muajin tetor. Në muajin shtator nga 25 vendime të marra vetëm 1 është i lidhur me sektorin kundër korrupsion, kurse në muajin tetor nga 36 vendime Qeveria ka nxjerr dy vendime të fushës kundër korrupsion. Në muajin shtator, respektivisht me 28 shtator 2011, Qeveria e Kosovës morri vendim që Z. Rrahim Rama emërohet Kryeshef Ekzekutiv në Agjencionin për administrimin e pasurisë së sekuestruar.<sup>9</sup> Ligji për Agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ka hyrë në fuqi me 1 janar 2010<sup>10</sup>. Agjencia është organ, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe udhëhiqet nga Kryeshefi. Edhe pse po bëhen gati dy vite nga hyrja e këtij ligji në fuqi nuk ka lëvizje/veprime serioze në zbatimin e tij. Përveç kësaj, problem parësor për zbatim është mungesa e një ligji themelor që do t'i obligonte autoritetet ta konfiskojnë pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme, duke e bërë atë pjesë integrale të hetimit, ndjekjes dhe ndëshkimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pra, në vend që shteti të vendosë bazën ligjore për të kodifikuar dhe sanksionuar veprimet që mundësojnë fitimin e pasurisë në mënyrë të

kundërligjshme, praktikë kjo e ndjekur nga pothuajse të gjitha vendet e tjera, është miratuar një ligj dytësor për administrimin e pasurisë së sekuestruar<sup>11</sup>. Kosova ende nuk e ka miratuar Legjislacionin kornizë për konfiskimin e pasurisë ndonëse Kryeministri Hashim Thaçi ka pohuar ta ketë iniciuar një gjë



të tillë nga mesi i vitit 2010. Ndoshta zgjedhja e kryeshefit të ri do ti shpejtoj disa gjëra për mirë. Në Mbledhjen e Qeverisë të mbajtur me datë 10 tetor 2011 u morr vendim për miratimin e Projekt-kod-it Penal të Republikës së Kosovës<sup>12</sup>, i cili Kod është përgatitur dhe sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Miratimi i këtij Projekt-kodit paraqet njërin ndër angazhimet direkte të Ministrisë së Drejtësisë, për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë penale si dhe eliminimit të zbrazëtive dhe mangësive ligjore në këtë fushë<sup>13</sup>. Edhe pse Qeveria

<sup>9</sup> Qeveria e Kosovës, vendimi Nr.03/39 (28.09.2011)

<sup>10</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/ L-141 (10.07.2009)

<sup>11</sup> Lëvizja FOL, raporti "Analizë mbi kornizën ligjore kundër pasurisë së përvetësuar në mënyrë të paligjshme, prill 2011

<sup>12</sup> Qeveria e Kosovës, vendimi Nr.01/41 (10.10.2011)

<sup>13</sup> Ministria e Drejtësisë, <http://www.md-ks.org/?page=1,8,464>

e Kosovës e ka miratuar këtë Projekt - kod, Projekt Kodi Penal I Kosovës prapë se prapë nuk është në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Shoqëria Civile, e cila ka kërkuar që në kuadër të këtij Kodi, ligji për deklarimin e rrejtshëm të pasurisë të konsiderohej Vepër Penale, mirëpo edhe kësaj radhe janë injoruar kërkesat dhe rekomandimet e Shoqërisë Civile. Vendim i fundit i Qeverisë së Kosovës lidhur me fushën kundër korrupsion për periudhën shtator-tetor 2011 është vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative të vitit 2011 të Qeverisë së Kosovës<sup>14</sup>. Strategjia Legjislative për vitin 2011 është miratuar me vendimin nr. 02/05, me datë 16 mars 2011, më pas është plotësuar me vendimet nr. 03/16, nr. 07/32 dhe së fundi me vendimin nr. 09/43 të datës 19 tetor 2011<sup>15</sup>. Me vendimin e fundit të Qeverisë së Kosovës, është vendosur që Projektligji për konfiskimin e pasurisë të jetë pjesë e Strategjisë Legjislative të vitit 2011, e me të cilin vendim shpresojmë që do të kompletohet paketa ligjore kundër korrupsion, e cila më pastaj do ti reduktoj ndjeshëm hapësirat ligjore që ekzistojnë në ligjet ekzistuese për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit<sup>16</sup>.


<sup>14</sup> Qeveria e Kosovës, vendimi Nr. 09/43 (19.10.2011)

<sup>15</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_Legjislative\\_2011-finale\\_e\\_plotesuar\\_me\\_19\\_10\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Legjislative_2011-finale_e_plotesuar_me_19_10_2011.pdf)

<sup>16</sup> Lëvizja FOL, Monitoruesi I Korrupsionit, Mars-Prill 2011, fq5

### Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës gjatë muajve shtator-tetor 2011 ka mbajtur 3 seanca plenare, nga të cilat njëra është mbajtur gjatë muajit shtator dhe dy tjerat në muajin tetor. Nga këto tri seance plenare për këto dy muaj, vetëm në seancën e muajit shtator është diskutuar për çështjen kundër korrupsion, respektivisht gjatë seancës së muajit shtator ku është zgjedhur drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsion. Në mbledhjen e Kuvendit të



muajit shtator, saktësisht me 22 shtator 2011, u shqyrtua rekomandimi I Komisionit për Legjislacion lidhur me zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion. Drejtuesi I këtij komisioni Arben Gashi prezantoi para Kuvendit dy kandidatët për drejtor të agjencisë, të cilët sipas tij i plotësojnë të gjitha kriteret formale-juridike të parapara me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsion<sup>17</sup>. Kandidatët e intervistuar për këtë pozitë ishin Hasan Preteni dhe Bashkim Zeqiri, të cilët dolën në votim për pozitën Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsion. Pjesëmarrës atë ditë në Kuvend ishin 94

<sup>17</sup> Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit, neni 8, paragrafi 3 ([http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_Agjencine\\_kunder\\_Korrupsionit\\_nr\\_03\\_L\\_159.pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Agjencine_kunder_Korrupsionit_nr_03_L_159.pdf))

deputet, nga të cilët 30 votuan për Bashkim Zeqirin, ndërkaq 54 votuan për Hasan Preteni, 10 vota ishin të pavlefshme. Kryetari I Kuvendit konstatoi se Hasan Preteni do të jetë drejtor i Agjencisë kundër Korrupsion për 5 vitet e ardhshme<sup>18</sup>. Përgjegjësitë e Drejtorit të Agjencisë sipas Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsion janë : të udhëheq dhe organizon punën e Agjencisë, të mbikëqyrë punën e nëpunësve të Agjencisë, përfaqëson Agjencinë brenda dhe jashtë vendit, menaxhon buxhetin e Agjencisë, lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare etj.


### Sistemi Gjyqësor

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Njëra nga arsyet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion pikërisht rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferimeve politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i fundit i

<sup>18</sup> Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion, neni 8, paragrafi 6 : (Drejtori zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të rizgjidhet vetëm edhe për një mandat tjetër)

EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovës ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe në forma të llojlojta janë evidentuar.<sup>19</sup> Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm kishte regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.<sup>20</sup> Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës** - përbëhet nga 13 anëtarë, dhe siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme.<sup>21</sup> Bazuar



në statistikat e këtij institucioni për muajin gusht-shtator shohim se në kuadër

<sup>19</sup> Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9

<sup>20</sup> Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2


<sup>21</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Neni 108, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 15 qershor, 2008, fq. 42




të kategorisë “shpërdorim i detyrës zyrtare” 14 lëndë janë pranuar në punë, asnjë lëndë në ka qenë në shqyrtim dhe vetëm 9 lëndë janë zgjidhur. Në kuadër të kategorisë “marrje e ryshfetit” kemi 2 lëndë të pranuar në punë dhe vetëm 1 lëndë është zgjidhur në fund të periudhës raportuese. Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi vetëm një lëndë të pranuar në punë dhe 1 lëndë po ashtu të zgjidhur në fund të periudhës raportuese.

### Policia e Kosovës

Policia e Kosovës perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Raporti i EULEX-it ka treguar një shkallë të tillë progresioni të Policisë së Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar<sup>22</sup>. Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se në muajt shtator-tetor janë dërguar gjithsej 44 lëndë në Prokurori: 16 raste në muajin shtator dhe 28 raste të tjera në muajin tetor.



Në kuadër të këtyre lëndëve 29 raste janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur, ndërkaq asnjë rast me kryerës N/N. Ndërkaq, në kuadër të rasteve të dërguara me raport të prokurorit janë gjithsej 15 raste: 5 raste të dërguara në muajin shtator dhe 10 raste në muajin tetor. Prej hetimeve të Policisë së Kosovës 13 zyrtarë kanë përfunduar të arrestuar: 4 në muajin shtator dhe 9 në muajin tetor. Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përllogaritet të jetë 679,285.00 €: 398,170.00 € në muajin shtator dhe 281,115.00 € në muajin tetor.



### Doganat e Kosovës

Doganat e Kosovës gjatë dy muajve kanë shqiptuar gjithsej 11 masa disiplinore. Në kuadër të tyre 2 kanë qenë në muajin shtator dhe nëntë tjerat në muajin tetor. Në kuadër të këtyre masave disiplinore 9 raste janë vërejtje me shkrim, 1 rast ndalim promovimi dhe një vërejtje gojore. Këto masa janë shqiptuar për mos paraqitje në punë, si dhe për sjellje jo profesionale dhe lëshime procedurale nga ana e zyrtarëve të Doganës së Kosovës. Ndërkaq, për muajin shtator dhe tetor nuk është iniciuar asnjë rast në Sektorin e Standardeve Profesionale.

<sup>22</sup> Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23

### Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Britanike në Kosovë. Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: [www.monikorr.org](http://www.monikorr.org)

### Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

### Kontakt:

Andrea Gropa 35, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Mob: +377 (0) 44 131 542  
Web: [levizjafol.org](http://levizjafol.org)  
E-mail: [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)